TË RËNËT BRITANIKË NË SHQIPËRI: TË VETMIT USHTARAKË TË HUAJ QË ERDHEN SI ÇLIRIMTARË

Mal Berisha

TË RËNËT BRITANIKË NË SHQIPËRI: TË VETMIT USHTARAKË TË HUAJ QË ERDHEN SI ÇLIRIMTARË

Hyrje

Mëngjesi i 29 tetorit 1944 do të mbetet i paharruar në kujtesën e atyre që njohin sakrificat për lirinë e Shqipërisë. Atë ditë, një skuadër e Forcave Ajrore Mbretërore Britanike (RAF), me avionin Halifax JP 244,148, u nis nga Brindisi me një detyrë të posaçme në kuadër të Operacioneve Ekzekutive Speciale (SOE): dërgimin e furnizimeve për forcat aleate dhe rezistencën shqiptare në pllajën e maleve të Çermenikës.

Menjëherë pas ngritjes, lidhja me avionin u ndërpre. Pas një kohe të shkurtër fluturimi, avioni mori flakë dhe u rrëzua, duke marrë me vete jetët e shtatë anëtarëve të ekuipazhit, të gjithë pjesëtarë të Forcave Aleate Britanike, që shkelën në tokën shqiptare jo si pushtues, por si çlirimtarë.

Ata ishin:

Piloti Edwin John Stubley
Rreshteri Charles Mabbs, farmacist
Rreshteri Alfred Coote, shofer
Rreshteri John Thompson, punonjës hekurudhash

Rreshteri Ernest Logan Brown, polic
Rreshteri Austin Donnelly, transportues qelqurinash
Rreshteri Richard Charles Knee, nënpunës

Pikërisht për këtë arsye, çdo vit, më 20 tetor, në Memorialin e të Rënëve Britanikë në Parkun e Tiranës, organizohet një ceremoni përkujtimore në nderim të anëtarëve të ekuipazhit të avionit *Halifax JP 244* dhe të rreshterit britanik Peter Twiddy. Ceremonia drejtohet nga Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, në prani të përfaqësuesve diplomatikë, ushtarakë dhe qytetarë që nderojnë kujtimin e atyre që ranë për lirinë e Shqipërisë.

Foto e ekipit britanik të rënë me datën 29 tetor 1944 në Shqipëri

ÇFARË ISHIN OPERATIVËT EKZEKUTIVË SPECIALË? (SOE)?

Në rrjedhën e Luftës së Dytë Botërore, pas rënies së Francës në duart e nazistëve, u bë e domosdoshme krijimi i një force britanike vullnetare dhe luftarake, e cila do të zhvillonte një luftë ndryshe ndaj ushtrive të Hitlerit. Kjo forcë mori emrin Special Operations Executive (SOE).

Misioni i saj ishte të kryente akte spiunazhi dhe sabotazhi në prapavijat armike, duke goditur drejtpërdrejt infrastrukturën ushtarake dhe logjistike të nazistëve. Luftëtarët e SOE-së kishin për detyrë të nxirrnin trenat nga shinat, të shkatërronin ura, si dhe të sabotonin fabrikat e prodhimit të armëve. Ata vepronin në mënyrë të fshehtë për të organizar dhe mbështetur luftën guerile në të gjitha vendet e pushtuara nga forcat naziste.

Më 16 korrik 1940, Kryeministri britanik Winston Churchill emëroi Hugh Dalton si drejtues politik të Special Operations Executive (SOE) dhe e urdhëroi menjëherë të niste veprimtarinë në terren. Kjo organizatë e fshehtë u ndërtua me shpejtësi dhe arriti të përfshijë 13.000 pjesëtarë, prej të cilëve 3.200 ishin gra, të trajnuara për operacione të ndërlikuara pas vijave të frontit armik.

SOE-ja u shpërnda zyrtarisht më 15 janar 1946, pas përfundimit të luftës. Një nga operacionet e saj të para dhe

më të suksesshme ndodhi në qershor të vitit 1941, kur agjentët e saj arritën të shpërthenin stacionin elektrik të Pessac në Francë. Ky akt sabotazhi u mirëprit në Londër si një arritje e madhe dhe forcoi bindjen se makineria ushtarake gjermane nuk mund të mposhtej vetëm me bomba, por edhe me aksione të guximshme të sabotazhit.

Ky sukses u bë pararendës i qindra operacioneve të tjera, të cilat u shtrinë në të gjithë Evropën e pushtuar dhe madje deri në Lindjen e Largët, përfshirë territoret japoneze.

Në vitin 1942, një skuadër e SOE-së vrau zëvendësin e Hitlerit, Reinhard Heydrich, me një granatë. Në Greqi, po në vitin 1942, ata shkatërruan urën e Gorgopotamos, duke i prerë furnizimet ushtrisë së Romelit në shkretëtirë. Në Norvegji, ata shkatërruan një fabrikë të ujit të rëndë, duke i dhënë fund ëndrrës naziste për prodhimin e një bombe atomike. U pa kwshtu se SOE mund të godiste armikun në çdo kohë dhe në çdo vend**.**

CILI ISHTE ROLI I SOE-SË NË SHQIPËRI?

Në aktet më të rëndësishme të ndërmarra nga ana e Britanisë së Madhe ndaj Shqipërisë, vend të veçantë zë futja e vendit tonë në hartën e veprimeve të SOE-së. Një numër i madh djemsh dhe vajzash britanikë erdhën në

Shqipëri për t'u ballafaquar me një terren dhe situatë krejtësisht të panjohur.

SOE, përveç vendeve të tjera si Franca, Polonia, Gjermania, Hollanda, Belgjika, Italia, Jugosllavia, Hungaria, Greqia, Kreta, Çekosllovakia, Norvegjia, Danimarka, Rumania, Abisinia dhe Azia Juglindore, veproi edhe në Shqipëri.

Një grup i vogël ndërlidhës hyri nga Greqia në Shqipëri në vitin 1943. Agjentët më të njohur të SOE-së që vepruan në vendin tonë ishin:

Julian Amery, Anthony Quayle, David Smiley dhe Neil "Billy" McLean.

Se si u zhvilluan operacionet e SOE-së në Shqipëri? Këtë na e ka përshkruar më së miri Rodrick Bailey, në librin e tij: **"Provinca e Egër" (*The Wildest Province*).**

SOE NË TOKËN E SHQIPEVE.

Sipas Roderick Bailey-t, në vitin 1943, një ekip i vogël elitë i ushtarëve britanikë filloi të zbriste me parashutë në malet e Shqipërisë së pushtuar. Ata ishin pjesëtarë të SOE-së dhe kishin për detyrë të gjenin dhe armatosnin çetat e luftëtarëve guerrilas, si dhe të sulmonin armikun sa më shumë që të mundeshin.

Këta agjentë nuk kishin shkelur kurrë më parë në Shqipëri dhe nuk kishin asnjë ide se çfarë do t'i priste atje.

Takim me Dr. Roderick Bailey, autor i librit "Provinca e Egër", u zhvillua më datë 14 shkurt 2013, në Ambasadën Shqiptare në Londër.
Në këtë aktivitet, kryetari i Shoqërisë Anglo–Shqiptare, ish–ambasadori Stephen Nash, mbajti kumtesën kryesore.

Në përpjekje për të mbijetuar në kushtet më ekstreme dhe në një terren tejet të vështirë, këta britanikë të rinj jetuan nën rrezikun e përhershëm për të rënë në duart e armikut, ku i priste vdekja e sigurtë. Përveç sëmundjeve dhe pamundësisë për një jetë të pastër, ata përballeshin edhe me një realitet tjetër po aq të rrezikshëm: konfliktin e brendshëm ndërmjet vetë çetave guerrile shqiptare.

Në këtë libër të jashtëzakonshëm, autori ka përdorur intervista me të mbijetuarit, ditare të fshehura për dekada

dhe dokumente të deklasifikuara së fundmi, të cilat hedhin dritë mbi historinë e jashtëzakonshme të SOE-së në Shqipëri.

Sipas dokumenteve të **SOE-së**, deri në vitin **1945**, kjo organizatë kishte dërguar në **Shqipëri** një sasi të konsiderueshme ndihmash ushtarake dhe logjistike për forcat e rezistencës.

Në total, u dërguan:

- **7.000 pushkë**,
- **5.000 armë gjysmë-automatike**,
- **1.800 mitraloza të lehtë**,
- **60 mitraloza gjysmë të rëndë**,
- **240 mortaja**,
- **25.000 bomba**,
- **25.000 granata dore**,
- **16.500.000 fishekë**,
- **si dhe një numër i madh pistoletash.**

Në aspektin logjistik dhe të nevojave jetike, u dërguan gjithashtu:

- **28.000 palë rroba ushtarake**,
- **57.000 palë çizme**,
- **14.000 batanije**,
- **390 fenerë**,
- **6 xhipa**,
- **1 motorbarkë**,

- **dhe qindra tonë me ushqime.**

Nga grupi i parë prej 50 britanikësh që zbritën në Shqipëri, 16 mbetën të vrarë, ndërsa 17 të mbijetuar u dekoruan për guximin dhe shërbimin e tyre. Gjatë gjithë periudhës së veprimtarisë së SOE-së në Shqipëri, **ranë në krye të detyrës 53 pjesëtarë** të këtyre forcave.

Autori e nis rrëfimin e tij dramatik me pjesë nga vepra e Ismail Kadaresë, ***"Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur"*.** Historia e mbetjeve mortore të të rënëve britanikë në Shqipëri është thellësisht e dhimbshme. Ata kurrsesi nuk mund të konsiderohen si pushtues apo armiq të Shqipërisë. Përkundrazi, erdhën si çlirimtarë, dhe dhanë jetën për të ndihmuar popullin shqiptar të çlirohej nga fashizmi dhe nazizmi.

SOE-ja u shpërnda zyrtarisht më 15 janar 1946, por menjëherë pas përfundimit të luftës, u ndërmorën përpjekje të mëdha për të mbledhur dhe sistemuar eshtrat e të rënëve, si në Shqipëri, ashtu edhe në të gjitha vendet ku kishin vepruar.

DRAMA E GJETJES SË MBETJEVE TË TRUPAVE USHTARAKË BRITANIKË NË SHQIPËRI

Regjimi i Enver Hoxhës, i cili kishte marrë një kurs të qartë — fillimisht pro-jugosllav dhe më vonë pro-sovjetik — u bë pengesë serioze për britanikët që përpiqeshin të merrnin eshtrat e djemve dhe vajzave të tyre të rënë në Shqipëri.

Autori tregon se, përkundër pengesave të mëdha të qeverisë komuniste, një oficer britanik i quajtur MacIntosh gjeti një mbështetje të jashtëzakonshme tek populli shqiptar, i cili u tregua bujar, mikpritës dhe thellësisht njerëzor ndaj tij.

Në shkurt të vitit 1946, pasi kishte udhëtuar fshat më fshat dhe breg më breg, MacIntosh arriti të mblidhte eshtrat e të rënëve britanikë në Shqipëri, duke përmbushur një mision me përmasa humane dhe historike.

Fatkeqësisht, MacIntosh u përzu nga qeveria shqiptare, i shpallur si "reaksionar dhe armik i popullit shqiptar", dhe misioni i tij mbeti i papërfunduar.

Por më e keqja ende nuk kishte ndodhur. Qeveria britanike, duke mos pasur më përfaqësim zyrtar në Tiranë, ia besoi ambasadës franceze detyrën për kujdesin dhe marrjen e eshtrave. Në vitin 1950, një atashe francez shkoi për të vizituar varrezat e britanikëve në Shqipëri...

Ai nuk gjeti asnjë gjurmë të tyre. Qeveria e Enver Hoxhës i kishte fshehur varret dhe nuk e lejoi që, as të vdekur, ata të preheshin në paqe në vendin ku ranë. E

drejta e këtyre njerëzve për të prehur në një vend të qetë u “fitua” vetëm pas rënies së diktaturës komuniste në Shqipëri. Vetëm atëherë, eshtrat e tyre u mblodhën dhe u vendosën me nderim në një varrezë të posaçme në Parkun e Tiranës, ku ndodhet sot Memoriali i të Rënëve Britanikë.

NDERIMI PËR TË RËNËT NGA KRYEMINISTRI SHQIPTAR DHE AMBASADORI BRITANIK NË TIRANË

Më datë 11 nëntor 2012, Ambasadori Britanik në Tiranë, Sh.T. z. Nicholas Cannon, dhe Kryeministri i asaj kohe, Dr. Sali Berisha, organizuan një shërbesë përkujtimore në varrezën e britanikëve në Parkun e Tiranës.

Në këtë vend prehen 53 të rënë, pjesëtarë të SOE-së dhe të forcave britanike që dhanë jetën për çlirimin e Shqipërisë.
Por vetëm 46 prej tyre kanë pllakat e varreve mbi kokë — një dëshmi e pengesave historike dhe e mungesës së plotë të të dhënave për disa prej tyre.

SHQIPËRIA I KA NJË BORXH NDERI KËTYRE TË RËNËVE

Për kontributin e tyre të çmuar në **çlirimin e vendit tonë**. Ata erdhën në një vend të panjohur, në kohë lufte, për

të ndihmuar një popull që nuk e njihnin, por që e mbështetën me jetën e tyre.

Pas kthimit në atdhe, veteranët e SOE-së që shërbyen në Shqipëri vazhduan të i shërbejnë vendit të tyre në fusha të ndryshme të jetës publike. Shumë prej tyre u bënë njerëz të shquar dhe politikanë të zotë, duke sjellë me vete përvojën, guximin dhe urtësinë që fituan në Shqipëri.

Le të veçojmë disa prej tyre:

Harold Julian Amery, Baron Amery of Lustleigh (1919–1996) – Politikan konservator britanik, i cili për më shumë se tre dekada ishte një figurë drejtuese e Partisë Konservatore dhe për 42 vjet anëtar i Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar.
Gjatë Luftës së Dytë Botërore, ai shërbeu si oficer ndërlidhës i SOE-së për lëvizjen e rezistencës antifashiste shqiptare në vitet 1943–1944, në kuadër të grupit të njohur si “Tre Muskëtierët”, së bashku me majorin David Smiley dhe kolonelin Neil McLean.

John Anthony Quayle (1913–1989) – Një nga aktorët më të mëdhenj të teatrit britanik, i njohur për rolet e tij klasike dhe kontributin në kulturën teatrale angleze. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, ai shërbeu si oficer i shërbimit të fshehtë britanik (SOE) dhe në vitin 1943 mbërriti në Tragjas, Shqipëri, ku kontribuoi në mbështetjen e rezistencës antifashiste.

Pas luftës, iu përkushtua skenës, duke drejtuar Teatrin Memorial të Shekspirit dhe më vonë duke hedhur themelet e Kompanisë Mbretërore të Teatrit Shekspirian (Royal Shakespeare Company).

Ndër rolet e tij më të njohura janë Falstaffi, Otello, Henri VIII, si dhe interpretimet e shumta përkrah Sir Laurence Olivier, në një galeri të pasur e të paharrueshme rolesh në teatër dhe film. Për ne shqiptarët, John Anthony Quayle mbetet

një figurë e dashur dhe e respektuar jo vetëm për kontributin e tij si aktor i madh britanik në teatër dhe film, por edhe për shërbimin e tij të veçantë gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri. Si oficer i njësisë **Special Operations Executive (SOE)**, ai u hodh me parashutë në zonat e Veriut të Shqipërisë në vitin 1944 dhe shërbeu përkrah forcave partizane për organizimin e rezistencës kundër pushtuesve nazistë.

Pas luftës, ai mbajti përherë një lidhje emocionale me Shqipërinë dhe ishte **anëtar aktiv i Shoqatës Anglo-Shqiptare (Anglo-Albanian Association – AAA)** në Londër, duke mbështetur përpjekjet për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe historike shqiptare dhe për informimin e opinionit britanik mbi çështjen shqiptare.

Në karrierën e tij artistike, John Quayle u shqua në skenën britanike dhe në filmat ndërkombëtarë. Ai luajti role të spikatura në filma si *The Guns of Navarone*, *Anne of the Thousand Days*, *The Fall of the Roman Empire*, dhe të tjera. U dallua për interpretimet e tij mbresëlënëse në teatrot prestigjioze të Londrës dhe për zërin e tij të veçantë dhe autoritar.

Captain John "Anthony" Quayle, CBE



Sir Anthony Quayle (from National Portrait Gallery)

Kolonel David Smiley (1916 – 2009) ishte një oficer i shërbimeve të fshehta britanike. Në luftën e Dytë Botërore ai ka luftuar në Palestinë, Irak, Persi, Siri si dhe ka vepruar me SOE–në, në Shqipëri dhe në Tailandë. Ai ka shkruar librin ”Albanian Assignment”.

Magaret Hasluck (1885 – 1948) shërbeu në SOE. Pas luftës, dhe pas ekzekutimit nga komunistët të mikut të saj shqiptar, Lef Nosi, ajo u sëmur rëndë dhe vdiq në varfëri

në Dublin në vitin 1948. Atë e ndihmuan miqtë e saj të SOE–së në ditët e fundit të jetës në mënyrë anonime.

Billy McLean (1918 – 1986) Në vitin 1943 McLean iu bashkua misoneve të SOE dhe zbriti në territoret e okupuara nëShqipëri. Në Prillin e vitit 1944 McLean bashkë me një ekip tëvogël të quajtur “Tre Mosketjerët” ku bënte pjesë David Smiley dhe Julian Amery u përpoqën të pajtonin grupet e ndryshme politke në Shqipëri
që të luftonin së bashku kundër nazistëve por nuk i arritën dot. Ai shërbeu dhjetë vjet si antar i Parlamentit Britanik.



HISTORIKU I GJETJES SË RRESHTERIT PETER TWIDDY DHE MISIONIT SAPLING 7

Në kuadër të përpjekjeve të Forcave Aleate për të mbështetur lëvizjet e rezistencës në Europën e pushtuar gjatë Luftës së Dytë Botërore, SAPLING 7 ishte një nga misionet e posaçme të Forcave Ajrore Mbretërore Britanike (RAF), të koordinuar me Departamentin Britanik të Operacioneve Speciale (SOE) në Shqipëri. Misioni kishte për qëllim furnizimin nga ajri të formacioneve të rezistencës antifashiste shqiptare me municione, pajisje dhe personel.

Ky operacion përfshinte katër ekipe të SOE-së, të cilat më 19 tetor 1943 u nisën nga Tokra, Libi, me dy avionë bombardues Halifax Mark II të përshtatur për furnizime. SAPLING 7, i udhëhequr nga Majori Gerry Field, kishte si objektiv të parashutonte dy agjentë të tjerë të SOE-së në zonën e **Vlorës**, përveç dërgesave të tjera logjistike.

Përplasja dhe pasojat tragjike

Avioni Halifax HR674, i pajisur me katër motorë Rolls-Royce Merlin dhe me një rreze veprimi prej mbi 1.800 km, fluturonte brenda limiteve të tij teknike. Por gjatë natës 19/20 tetor 1943, avioni u përplas në malet pranë Dukatit, rreth 16 milje në jug-juglindje të Vlorës. Përplasja ishte fatale për të gjithë ekuipazhin – nuk pati të mbijetuar.

Sipas rrëfimit të mëvonshëm të Majorit Field, vetëm tre trupa mundën të identifikoheshin për shkak të dëmtimeve ekstreme: Rreshteri i Fluturimit Williams, Kapiteni Careless dhe Ndërlidhësi Rockingham. Mbetjet e tyre u zhvendosën më pas në Varrezat Përkujtimore të Tiranës, pranë Parkut të Madh të Liqenit, ndërsa anëtarët e tjerë të ekuipazhit përkujtohen në Memorialin e Alamein-it, në Egjipt.

Rreshteri Peter Twiddy: një jetë e prerë në ditëlindjen e tij

Ndër viktimat ishte edhe Rreshteri Peter Twiddy, lindur më 20 tetor 1921 në Stockwell, Surrey, djali i Albert Twiddy dhe Elsie Ward. Fati tragjik bëri që ai të humbiste jetën ditën e ditëlindjes së tij të 22-të, pikërisht më 20 tetor 1943, në Shqipëri – një vend që nuk e njihte, por për lirinë e të cilit ai sakrifikoi jetën.

Për dekada, mbetjet e tij nuk ishin të identifikuara dhe ai u përkujtua vetëm në memoriale të përgjithshme. Por falë përpjekjeve të vazhdueshme për zbardhjen e fatit të ushtarakëve të rënë në Shqipëri, më në fund Trupi i

Rreshterit Twiddy u identifikua dhe u vendos që ai të prehet në varrezat tek memoriali I të rënëvë britanikë në Tiranë.

STATUJA E HEROINËS SË SOE-S NË LONDËR

PËRMENDORJA QË FLET ME HESHTJE

Në Londër, buzë lumit Tamiz, gjendet një statujë bronxi që përfaqëson anëtarët e njësisë së famshme britanike të Luftës së Dytë Botërore – SOE (Special Operations Executive). Sa herë kaloja në shtegun përgjatë lumit, në rrugën që të çon nga Ura e Lambeth-it drejt London Eye,

ndalesha përpara asaj përmendoreje, përpara atij busti që të detyron të ndalosh, të heshtësh dhe të reflektosh.

Ajo është figura e një gruaje – me një vështrim të mprehtë, portret të bukur dhe të rregullt, me një bukuri klasike që nuk sfidon natyrën, por i nënshtrohet asaj me dinjitet. Skulptura ruan përmasat e natyrshme të trupit njerëzor, pa shformime, pa shtrembërime stilistike, pa asnjë tendencë për glorifikim apo hiperbolizim që do ta kthente në një super-njeri, super-heroinë, apo ikonë abstrakte të ndonjë epoke të zhurmshme.

Ajo është realiste, e përmbajtur, e qetë në madhështinë e saj. Pikërisht siç do ta kërkonte Auguste Rodin, mjeshtri i skulpturës franceze, kur u mësonte studentëve të tij për raportin mes formës dhe përmbajtjes, për unitetin mes fizikut dhe shpirtit të një vepre arti. Dhe pse jo, edhe Odhise Paskali ynë do ta kishte pranuar me përulësi një vepër të tillë si shembull të rrallë të estetikës klasike në shërbim të kujtesës.

Jam ndalur shumë herë përpara atij busti. Sa herë që kam kaluar pranë tij, e kam fotografuar – ndoshta si një mënyrë për të ruajtur në kujtesë jo thjesht një vepër arti, por një copëz historie të madhe njerëzore. Në një nga këto raste, fotografinë e këtij busti e kam përdorur edhe në librin tim *Realitetet Shqiptaro–Britanike*, si ilustrim në kapitullin ku trajtohet veprimtaria e grupit britanik të njohur me emrin **Special Operations Executive (SOE)**.

Ky portret i jashtëzakonshëm i është kushtuar pikërisht atyre burrave dhe grave të guximshme që, në një nga periudhat më të errëta të historisë evropiane, arritën të depërtojnë thellë në prapavijat e armikut nazist. Ata ishin më shumë se agjentë – ishin bartës të një misioni të lartë njerëzor, shpesh të heshtur dhe të padukshëm, por gjithnjë të pranishëm në përpjekjen për liri.

Ky bust, në heshtjen dhe thjeshtësinë e tij, përfaqëson jo vetëm një figurë të vetme, por gjithë një brez idealistësh që, përmes sakrificës së tyre, u bënë pjesë e pandashme e historisë sonë të përbashkët.

Ndalohesha me respekt përpara saj, sa herë i kaloja pranë, pasi ajo përfaqëson ata që e shpëtuan botën nga katastrofa. Njëprej ditëve të shëtitjeve të mia buzë Lumit Tamiz takova autorine asaj skulpture.

TAKIMI ME SKULPTORIN IVAN SAXTON

Ai ishte Ivan Saxton – dhe po e pastronte me duart e veta bustin, të cilin e kishte krijuar vetë. Më tregoi me pasion se si kishte realizuar këtë vepër, duke pasur si model një anëtare të vërtetë të SOE-së, që kishte jetuar dikur në atë zonë të Londrës, ku sot qëndron busti.

“Ajo heroinë më ka frymëzuar për këtë vepër dhe ishte vetë ajo që më pozoi,” – më tha Ivani.
“Në tiparet e saj pashë aq shumë karakteristika të një përfaqësueseje të kësaj organizate të jashtëzakonshme. U

përpoqa t’i shprehja të gjitha në një portret – guximin, vendosmërinë, heshtjen dhe dinjitetin.”

Në vështrimin e tij kishte një respekt të thellë për figurën që kishte përjetësuar në bronz – një simbol jo vetëm i një gruaje të veçantë, por i të gjithë atyre burrave dhe grave që kishin marrë pjesë në radhët e Special Operations Executive.

Operativët Specialë Ekzekutivë janë të vetmit ushtarë të huaj që, në gjithë Historinë e gjatë të Shqipërisë, kanë ardhur jo si pushtues, por si çlirimtarë – si liberatorë. Ata mbeten përherë në kujtesën tonë si dëshmi e miqësisë, sakrificës dhe besnikërisë ndaj lirisë.

Memoriali i të rënëve brtianikë në Shqipëri tek kodrat e Liqenit Artifical në Tiranë

Mal Berisha